

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCAVE

UDHEZIM

Nr. 2/1, date 11.07.1996

PER  
KIISHTET QE DUHET TE PLOTESOHEN DHE PROCEDURAT QE DUHET TE  
NDIQEN PER TE PERFITUAR PERJASHTIMIN NGA TAKSAT DOGANORE TE  
IMPORTIT

HIDROKARBURET

Ne mbeshtetje te nenit 23 dhe 20/8 te ligjit nr. 7609, date 22.09.1992 "Per tarifat doganore", ndryshuar me ligjin nr.8100, date 28.03.1996, Ministri i Financave,

UDHEZON:

107. Ne udhezimin e Ministrit te Financave nr.2, date 05.06.1996 "Per kushtet qe duhet te plotesohen dhe procedurat qe duhet te ndiqen per te perfituar perjashtimin nga taksat doganore te importit" teksti qe i takon hidrokarbureve do te jete si vijon :
108. Ne zbatim te pikes (ç) te nenit 20/5 të Ligjit "Për tarifat doganore" përjashtohen nga taksat doganore të importit mallrat që do te importohen nga kontraktuesit dhe nenkontraktuesit në përputhje me Ligjin Nr. 7746 date 28.07.1993, "Për Hidrokarburet" dhe Ligjin nr.7811, date 12.04.1994, mbi miratimin e Dekretit nr. 782, date 22.02.1994, "Per sistemin fiskal te sektorit te hidrokarbureve (Kerkimi dhe Prodhimi)", neni 3.
109. Mallrat për të cilat bëhet jalë në pikën 108 mund te jene dy llojesh :
  - a) makineri, pajisje, materiale, furnizime, etj, që i nevojiten Kontraktuesit dhe/ose Nënkontraktuesit për të realizuar operacionet e naftes;
  - b) sende personale dhe mjete te jeteses të personelit të huaj që punon në kuadër të Marrëveshjes Hidrokarbure;
110. Për të fituar përjashtim nga taksat doganore në bazë të pikës 108, personi i interesuar, duhet të paraqesë ne Drejtorine e Pergjitheshme te Doganave, para *importimit*, nje kerkese ku duhet të tregojë :

- a) ekzistencën e një Vendimi të Qeverise qe miraton Marreveshjen Hidrokarbure;
- b) natyrën e makinerive, pajisjeve, materialeve te konsumit, furnizimeve te tjera, etj, që do te importohen gjate fazave te kerkimit, zhvillimit apo prodhimit sipas programeve te miratuara nga Agjensia Kombetare e Hidrokarbureve;
- c) vendin ku do te instalohen apo konsumohen mallrat per te cilat kerkohet perjashtim.

111. Kerkeses duhet ti bashkangjiten keto dokumente :

- a) teksti i vendimit te Keshillit te Ministrave qe ka miratit marreveshjen;
- b) vertetimin nga Agjensia Kombetare e Hidrokarbureve per identitetin dhe koncesionet qe i jane dhene kontraktuesit dhe/ose nenkontraktuesit, i cili mund te leshohet ne menyre globale per te gjithë sasine e mallrave qe eshte parashikuar te importohen ne baze te marreveshjes perkatese hidrokarbure;
- c) cdo dokument qe verteton marredheniet me palet ne marreveshje;
- d) nje liste te mallrave qe ka ndermend te importoje.

112. Drejtoria e Pergjitheshme e Doganave, pasi disponon dokumentat e mesiperme, ne kohen me te shpejte te mundur, duhet te leshoje nje autorizim ne emer te personit te interesuar dhe per kompetence ne zbatim nje dege doganore te caktuar. Sipas vertetimit qe do te leshoje Agjensia Kombetare e Hidrokarbureve, autorizimi mund te leshohet ne menyre globale per te gjithë sasine e mallrave qe eshte parashikuar qe do te importohet ne baze te Marreveshjes ose here pas here per pjese te vecanta te mallrave qe do te importohen.

113. Çlirimi i mallrave, per perdorim te brendshem, qe pershkruhen ne autorizim, behet ne zyren doganore kompetente. Titullari i autorizimit per perjashtim nga taksat doganore te importit, duhet qe se bashku me deklaraten doganore dhe dokumentat e tjera qe paraqiten ne rastin e importimit te mallrave, tu paraqese organeve doganore perkatese edhe autorizimin e leshuar nga Drejtoria e Pergjitheshme e Doganave.

114. Dega Doganore kompetente duhet te hape nje dosje me anen e se ciles duhet te ndjeke dinamiken e importeve qe do te kryhen mbi bazen e autorizimit deri ne perfundim te vlefshmerise se tij. Ne dosje duhet te depozitohen te gjitha praktikat e importit qe do te kryhen mbi bazen e autorizimit te leshuar.

115. Ne rastet kur nuk lejojne kushtet qe autorizimi te jete global, do te leshohen autorizime te vecanta me vlefshmeri kohore jo me te gjate se nje muaj, per cdo parti malli qe do te importohet ne baze te marreveshjes. Per kete, pervec kerkeses

se pare qe eshte bere, para importimit te mallrave duhet te behet nje kerkese e vecante prane Drejtorise se Pergjitheshme te Doganave. Organet doganore kompetente do te lejojne perjashtimin nga taksat doganore vetem per mallrat per te cilat eshte leshuar shprehimisht autorizimi.

2. Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI

Dylber VRIONI d.v.